



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.507/10 prot.

Datë 03.03.2026

V E N D I M
Nr.340/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.03.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 302/2026, datë 24.02.2026 për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-75978-02-12-2026, me objekt: Loti 1: “Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave”, me fond limit 29,065,600.00 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK me NIPT L01314031G dhe adresë: Rruga e Kavajës, Ndërtesë 2 katëshe, Kati 2 , Km 6, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.
Rruga ”Reshit Çollaku”, Godina nr.6/337(në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 24.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 302/2026 ku vendosi:

1. *Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-75978-02-12-2026, me objekt: Loti 1: “Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave”, me fond limit 29,065,600.00 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.*
2. *Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet e DST sipas konstatimeve të KSHA për procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe të publikojë ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
4. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Vilnik Motors” SHPK*
5. *Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 658/9 prot., datë 26.02.2026, protokolluar me tonën nr. 507/7 prot., datë 02.3.2026, autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin nr. 302/2026, datë 24.02.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-75978-02-12-2026, me objekt: Loti 1: “Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave”, me fond limit 29,065,600.00 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 658/9 prot., datë 26.02.2026, protokolluar me tonën nr. 507/7 prot., datë 02.3.2026, autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin nr.302/2026, datë 24.02.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-75978-02-12-2026, me objekt: Loti 1: “Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave”, me fond limit 29,065,600.00 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se autoriteti kontraktor ka hartuar dhe publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike shtojcën, e cila është në përputhje me vendimin nr.302/2026, datë 24.02.2026 të këtij Komisioni.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-75978-02-12-2026, me objekt: Loti 1: “Riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave”, me fond limit 29,065,600.00 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

